



Çfarë do të thotë për ju ndalimi i hyrjes ose vendimi për sinjalizim?

Ju u është shpallur ndalimi i hyrjes ose ju është dhënë vendimi i sinjalizimit. Ose ndalimi i hyrjes dhe vendimi për sinjalizim. Vendimi që keni marrë thotë se përse ju u është shpallur ndalimi i hyrjes ose një vendim për sinjalizim. Në këtë broshurë shpjegohet se çfarë është ndalimi i hyrjes ose vendimi për sinjalizim dhe çfarë do të thotë kjo për ju.

1. Çfarë është një ndalimi i hyrjes?
2. Çfarë është vendimi për sinjalizim?
3. Sa zgjat ndalimi i hyrjes ose vendimi për sinjalizim?
4. Çfarë do të thotë sinjalizimi në sistemin e informacionit?
5. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga SIS ose E&S?
6. Çfarë ndodh me një ndalim hyrje nëse ju prap se prap do jeni në Holandë?
7. Çfarë mund të bëni ju nëse nuk pajtoheni me ndalimin e hyrjes ose vendimin për sinjalizim?
8. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?
9. Si të kërkonti shfuqizimin (e përkohshëm) të ndalimit të hyrjes ose vendimit për sinjalizim?
10. Çfarë duhet ju të bëni nëse keni pyetje?

1. Çfarë është një ndalim i hyrjes?

Nuk ju lejohet të udhëtoni dhe të jeni në shtetet (vendet) e Bashkimit Evropian (BE), të zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) dhe në Zvicër për një periudhë të caktuar kohore. Lexo në www.ind.nl/eueer dhe www.ind.nl/en/eueea cilat janë shtetet (vendet) e BE/ZEE. Ne i referohemi tutje të gjitha këtyre vendeve si BE. Ndalimi i hyrjes nuk vlen për Irlandën.

Ju do merrni një ndalim hyrje vetëm pas një vendimi të urdhërtit për kthim. Ky është një vendim që thotë se ju nuk ju lejohet të jeni në Holandë dhe se duhet të largoheni nga BE. Dhe ju duhet të ktheheni në shtetin (vendin) që thuhet në vendimin e kthimit. Ose në një shtet (vend) tjetër jashtë BE-së (pa Irlandë) ku ju lejohet të qëndroni.

2. Çfarë do të thotë vendimi për sinjalizim?

Vendimi për sinjalizim është i ngjashëm me ndalimin e hyrjes. Nga ky vendim për sinjalizim ju nuk mundeni të udhëtoni dhe të qëndroni në BE. Është e mundur që vendimi për sinjalizim vlen vetëm për Holandë? Ju do të merrni një vendim si i sinjalizuar nëse përbën një rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare.

3. Sa do zgjasë ndalimi i hyrjes ose vendimi për sinjalizim?

Varet nga situata juaj se sa vite zgjat ndalimi i hyrjes ose vendimi për sinjalizim. Në vendimin që keni marrë tregon se sa do të zgjasë ndalimi i hyrjes ose vendimi i sinjalizimit për ju.

Kohëzgjatja e ndalimit tuaj të hyrjes ose vendimit për sinjalizim fillon në datën kur ju largoheni nga BE. Nëse vendimi për ju i sinjalizimit vlen vetëm për Holandë? Atëherë kohë zgjatje fillon në ditën kur ju largoheni nga Holanda. Kur IND e dinë që ju jeni larguar nga BE? Atëherë ndalimi juaj i hyrjes ose vendimi për sinjalizim do të përfundoj kur të ketë përfunduar periudha e cekur. Në këtë rast, sinjalizimi do të largohet nga sistemi i informacionit. Dhe më pas mund të udhëtoni përsëri në Holandë dhe në vendet tjera të BE-së. IN DE dinë që ju jeni larguar nga Holanda vetëm nëse e tregoni këtë në aplikimin tuaj për heqjen e vendimit për sinjalizimin tuaj. Lexoni në pytjen 4 se çfarë është sinjalizimi në sistemin e informacionit.

4. Çfarë do të thotë sinjalizimi në sistemin e informacionit Shengen (SIS)?

Ju do jeni sinjalizuar për ndalimin e hyrjes ose vendimin për sinjalizim. Të jesh i sinjalizuar ose sinjalizimi do të thotë që autoritetet e vendosin emrin tuaj në sistemin e informacionit. Rojet kufitare dhe policia e shohin përmes sinjalizimit tuaj në sistemin e informacionit se ju keni një ndalim hyrje ose vendim për sinjalizim. Pas kontrolës **ata mund t'ju ndalojnë** në kufi. Në atë rast nuk do të lejoheni të hyni në vend. Në atë vendim tregohet se në cilin sistem ju do të jeni i sinjalizuar, www.ind.nl/schengengebied ose www.ind.nl/schengenarea.

Janë 2 sisteme

- Executie & Signalering (E&S): Ky është sistemi i informacionit i policisë së Holandës dhe policisë kufitare mbretërore.
- Schengeninformatiesysteem (SIS): Ky është një sistem Europian në të cilin policia e kufirit dhe policia e shteteve shengen mund të shikojnë. Lexo se cilat shtete janë shtete të shengenit në www.ind.nl/nl/terugkeerbesluit ose www.ind.nl/en/returd-decision.

Ju mund të sinjalizoheni vetëm në 1 sistem. Një sinjalizim në SIS për një ndalim hyrjeje ose për një vendim për kthim dhe ndalimi i hyrjes ka përparësi ndaj një sinjalizimit për lëshimin e një vendimit për sinjalizim.

Së pari sinjalizimi për vendimin për kthim

Sinjalizimi për ndalimin e hyrjes nuk ndodh menjëherë. Fillimisht do të regjistroheni në SIS për vendimin e kthimit. A jeni larguar nga BE dhe a është IND në dijen tuaj për këtë? Pastaj sinjalizimi juaj do të ndryshojë në një sinjalizim për ndalimin e hyrjes. Ju nuk ju lejohet më të udhëtoni dhe nuk mund të jeni në BE. Lexoni më shumë rreth sinjalizimit dhe vendimit të kthimit në www.ind.nl/nl/terugkeerbesluit ose www.ind.nl/en/return-decision.

Vendimi për lëshimin e sinjalizimit dhe ndalimit të hyrjes

Vendimi mund të përmbajë vetëm një vendim, vendimin për sinjalizim. Një vendim me vendimin për një sinjalizim dhe një ndalim hyrje është gjithashtu i mundur.

E drejta e qëndrimit në BE dhe ndalimi i hyrjes nga Holanda

A keni tashmë të drejtën e qëndrimit në një shtet të BE-së? Dhe nëse ju kanë vendosur autoritetet Holandeze një ndalim hyrjeje më gjatë se 2 vite dhe vendimin për sinjalizim? Atëherë do të kërkojë nga shteti i BE-së që të tërheq të drejtën e qëndrimit tuaj? Nëse shteti i BE-së tërheq të drejtën tuaj të qëndrimit. Atëherë ju do të sinjalizoheni në SIS vetëm për detyrimin për kthim dhe ndalimin e hyrjes. Nëse ju do vazhdoni të mbani të drejtën e qëndrimit atëherë IND do shfuqizon ndalimin e hyrjes. Dhe ju do të sinjalizoheni për vendimin e sinjalizimit në (E&S). Nëse një shtet i BE-së ju tërheq prap se prap më vonë të drejtën e qëndrimit, atëherë IND do të ju sinjalizojë për vendimin e sinjalizimit në SIS.

5. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga SIS ose E&S?

- Nëse është e sigurt se kohëzgjatja e ndalimit të hyrjes dhe vendimit për sinjalizim ka skaduar. Dhe se ju që nga largimi i juaj nuk keni ardhur më
- Nëse IND e di që ju u është dhënë e drejta e qëndrimit në një vend të BE-së pas ndalimit tuaj të hyrjes. Më pas IND do të heqë ndalimin tuaj të hyrjes dhe do të heqë sinjalizimin tuaj nga SIS. Nëse ju jeni një kërcnim për rendin publik dhe sigurinë nacionale, autoritetet mund të vendosin një masë tjetër ndaj jush. Ju do të sinjalizoheni për këtë në sistemin e informacionit E&S.
- Ju keni kërkuar që të shfuqizohet ndalimi juaj i hyrjes ose vendimin për sinjalizim. Dhe nëse kjo kërkesë është miratuar.
Pyetja 9 shpjegon se si të kërkohet shfuqizimin. Nëse ju do të merrni një shfuqizim të përkoshme të ndalimit tuaj të hyrjes ose vendimit për sinjalizim? Atëherë sinjalizimi juaj do mbetet në SIS ose E&S.

6. Çfarë ndodhë me ndalimin e hyrjes nëse ju prap se prap jeni në Holandë?

Udhëtimi në Holandë dhe qëndrimi në Holandë është i dënueshëm. Mund të marrësh një dënim me burg deri në 6 muaj maksimalisht ose një gjobë prej disa mijra Euro. Kjo ceket në nenin 197 të kodit penal dhe nenin 108 të ligjit për të huajt.

7. Çfarë mund të bëni nëse nuk jeni i pajtimit me ndalimin e hyrjes dhe vendimit për sinjalizim?

Kjo varet nga situata juaj. Ju mund të bëni një ankimim tek IND ose të apelonit në gjykatë. Në vendim tregohet se si mund ta bëni këtë.

8. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?

- Nëse është e sigurt se kohëzgjatja e ndalimit të hyrjes ose vendimit për sinjalizim ka skaduar.
- Ju keni kërkuar shfuqizimin ndalimit të hyrjes ose të vendimit për sinjalizim dhe se kërkesë u është miratuar.

9. Si të kërkonte shfuqizimin (e përkohshëm) e ndalimit të hyrjes dhe vendimit për sinjalizim?

Ju mund të kërkonte shfuqizimin (të përkohshme) e ndalimit të hyrjes ose të vendimit për sinjalizim. Për shembull, sepse ju duhet të jeni në Holandë përpara se të skadojë ndalimi juaj i hyrjes ose vendimi për sinjalizim. Ju mund të kërkonte shfuqizim të përkohshëm në situata shumë të veçanta dhe urgjente.

Për shembull sepse periudha e ndalimit tuaj të hyrjes ose vendimit për sinjalizim ka skaduar më. Dhe nëse IND nuk e di se ju jeni larguar nga Holanda nëse ju jeni i sinjalizuar në E&S. Ose nëse IND nuk e di se ju jeni larguar nga BE nëse ju jeni i sinjalizuar në SIS.

Për këtë mund të përdorni formularin e *kërkesës për të shfuqizuar një deklaratë të padëshirueshmërisë ose ndalimit të hyrjes* ose vendimin për sinjalizim (9004 of 9504) në faqen e internetit për këtë qëllim. Të plotësoni këtë dhe ta dërgoni në IND. Ose ju dërgoni një letër në IND me një shpjegim në të cilën ju kërkonte që ajo të shfuqizohet. Gjithashtu dikush tjetër mund të kërkojë shfuqizimin në emrin tuaj. Ju duhet të i jepni atij personi lejen zyrtare për të ndërmarrë veprime në emrin tuaj. Ju e vendosni këtë në letër me nënshkrimin tuaj. Kjo quhet autorizim.

10. Çfarë duhet të bëni nëse keni pyetje?

- Vizitoni faqen tonë të internetit në www.ind.nl/inreisverbod ose www.ind.nl/en/entry-ban.
- Telefononi linjën e informacionit të IND në +31 88 043 04 30. Ky numër mund të arrihet nga e hëna deri të premten nga ora 09.00 deri në ora 17.00.

Asnjë e drejtë nuk mund të rrjedhë nga përmbajtja e publikimit. Nëse përkthimi çon në dallime në interpretim, versioni Holandez do të mbizotërojë. Teksti nga ky botim mund të përdoret me kusht që të përmendet burimi.